

UDHËZIM
Nr.29, datë 5.10.2010

**PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2010-2011 NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR ZBATIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë me kohë të plotë, të fillojë më 11 tetor 2010 dhe të përfundojë më 30 shtator 2011.

2. Viti akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, me kohë të plotë, të fillojë në datën 25 tetor 2010 dhe të përfundojë më datën 30 shtator 2011.

3. Viti akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, të fillojë në datën 1 nëntor 2010 dhe të përfundojë në 30 shtator 2011.

4. Periudha 24 dhjetor 2010 deri më 3 janar 2011 të jetë periudhë pushimesh për studentët.

5. Nga institucionet publike të arsimit të lartë të merren masat për zbatimin e udhëzimit të Ministrit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” për të pajisur me numrat e matrikullimit të gjithë studentët e vitit të parë deri më 26 nëntor 2010.

6. Të dhënat e regjistrave të njësive kryesore të dërgohen në MASH në formë elektronike në programin Excel brenda datës 17 dhjetor 2010.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtorinë e konvikteve listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

8. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi për vitin akademik 2010-2011.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj